



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafit_ dhe nenit 23 paragrafit 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit nga parashtruesi nga, dhe të tjerë, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK) në vazhdimin e seancës së 45-të të mbajtur me datë 29.12.2020 morri

VENDIM

Procedura për lëndën 12-2931 ga viti 2019, formuar pas denoncimit nr. 12-2931/1 me datë 30.05.2019, dorëzuar nga parashtruesi nga dhe të tjerë, **NDËRPRITET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim të mëtutjshëm për lëndën 12-2931 nga viti 2019, në denoncimin e dorëzuar ka vepruar organ tjetër kompetent.

Lënda me numër 12-2931 nga viti 2019, të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i Komisionit shtetëror, me sqarimin.

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin – në formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

Sqarim

Lënda me numër 12-2931 nga viti 2019 e formuar pas denoncimit nr. 12-2931/1 me datë 30.05.2019, dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nga parashtruesi nga dhe të tjerë.

Denoncimi i dorëzuar ka të bëjë me kërkesën për rishikim të vendimit të plotfuqishëm marrë nga Ministria e transportit dhe lidhjes, njësia rajonale, të cilin Kadastra e Komunës nuk e merr parasyshtë dhe në evidencën kadastrale nuk ka bërë regjistrim të pronës së transformuar në emër të parashtruesit dhe personave tjerë si trashëgues ligjor të të njëjtës, kurse prona i është dhënë në qeverisje në personi të tretë të cilit i është dhënë edhe fletë-pronësi, gjë që sipas parashtruesit të denoncimit ka qenë veprim joligjor nga ana e kadastrës.

Gjatë rishikimit të rastit të lëndës Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK) i merr parasyshtë të gjitha akuzat e parashtruesit dhe me qëllim të caktimit të gjendjes së plotë faktike për këtë rast të denoncuar, KSHPK dorëzoi kërkesë për të dhëna dhe informacione deri tek Agjensioni për kadastër të patundshmërive në RMV – Njësia rajonale Nga procedura e realizuar për caktim të gjendjes faktike, KSHPK e konstatoi këtë:

- Në rastin konkret bëhet fjalë për akuza për veprime joligjore në Kadastrën në gjatë regjistrimit të të dhënave në evidencën kadastrale të pronës për të cilën nga ana e

- Ministrisë për transport dhe lidhje – NJR - me datë 06.02.2004 është dhënë vendim me nr., për transformim me të drejtë tokë ndërtimore në të drejtë në pronësi në bazë të pronësisë paraprake, me të cilën personit nga e drejta e shfrytëzimit të tokës ndërtimore në KP nr. KK në sipërfaqe të përgjithshme prej 2000 m² i është traspformuar në të drejtë pronësie dhe personi është obliguar që vendimin e lëndës ta zbaton në librin publik për regjistrim të të drejtës për patundshmëri. Parashtrusit e denoncimit janë trashëgimtar ligjor të pronës së lëndës dhe kërkojnë që të rishikohet urgjentisht Vendimi për transformim të të drejtës të tokës ndërtimore në të drejtë pronësie në bazë të pronësisë paraprake dhënë nga Ministria e transportit dhe lidhjes, e cila ka qenë e plotëfuqishme por të cilën Kadastra e Komunës nuk e ka marrë parasyshtë dhe në evidencën kadastrale nuk e ka regjistruar pronën e transformuar në emër të parashtruesit dhe personave tjerë si trashëgimtarë ligjor të të njëjtës, por për pronën është dhënë fletë-pronësi në emër të personit të tretë.
- Në lidhje me rastin e lëndës është regjistruar procedurë administrative pas parashtrimit të padisë nga ana e parashtruesit të denoncimit përshkak të gjendjes së caktuar gabimisht, kundër Vërtetimit që është dhënë me datë 28.11.2012 nga ana e Agjencionit për kadastrë të patundshmërive – Njësia për kadastrë të patundshmërive , për shkak të largimit të gabimit teknik, me të cilin vërtetim Kadastra vërteton se është bërë largim i gabimit teknik gjatë mirëmbajtjes së kadastrës së themeluar për KK pas denoncimit nga personi Në procedurë është marrë vendikt nga Gjykata administrative me nr. U-1 nr. me datë 12.02.2015, me të cilën padia e parashtruar është aprovuar dhe vërtetimi i dhënë është asgjësuar, kurse në sqarimin e vendiktit është theksuar se duke vlerësuar ligjësinë e vërtetimit të diskutueshëm, gjykata gjeti se e njëjta është jologjore dhe me atë është dëmtuar Ligji, në dëm të parashtruesit të padisë si dhe është dëmtuar e drejta e procedurës për shkak se me vërtetimin është bërë ndryshim, gjegjësisht është bërë fshirje e drejtave të regjistruara në kadastrën e patundshmërive dhe nuk është bërë menjanim i gabimit teknik, për këtë arsye Gjykata gjeti për nevojë për rishikim të përsëritur dhe vendimmarrje për lëndën me çka i sugjerohet Kadastrës gjatë veprimit të përsëritur t'i merr parasyshtë të kuptuarit juridik dhe vërejtjet dhënë nga kja gjykatë.
 - Për këtë rast është parashtruar edhe ankesë deri në MPB por parashtruesi i denoncimit nuk ka informacione se a kanë vepruar dhe si është vepruar nga ana e tyre.
 - Me datë 04.07.2020, me kërkesë të KSHPK, është dorëzuar përgjigje nga Agjensioni për kadastra të patundshmërive – Njësia për kadastrë të patundshmërive, me të cilën dorëzohet Vërtetim për rishikim të historiatit të regjistrimeve të bëra në parcelën kadastrale të lëndës dhe me inspektimin në të njëjtën është konstatuar se, prona e lëndës me sipërfaqe prej 2200m² me kontratë për shitë-blerje nga viti 1978 është regjistruar në emër të nga Në vitin 2004 janë bërë ndryshime në pronë në bazë të vendimit e Zyrës shtetërorer për çështje gjeodezike; vendiktin nga Gjykata apikale e RM dhe Gjykatës themelore, lajmërim dhe instruksione nga DRGJ – Shkup gjatë së cilën një pjesë e pronës në sipërfaqe prej 1569m² është bashkuar me parcelë tjetër kadastrale dhe është formuar parcelë e re kadastrale e cila ka qenë regjistruar në emër të RM me sipërfaqe gjithsej prej 9633m², kurse pjesa e mbetur e pronës me sipërfaqe prej 631m² regjistruar në PL në emër të personit nga Në vitin 2008 është bërë ndërhyrje nga

ana e Kadastrës dhe parcelave kadastrale në mes të cilave edhe parcela e lëndës PK kanë fituar numra të rinj, prandaj prona e lëndës është futur në përbërje të PK..... /2 /4 dhe

Prona është evidentuar në PK me sipërfaqe prej 590m² është shënuar me IL në emër të RM kurse personi shfrytëzues nga kurse në vitin 2011 në bazë të vendimit të trashëgimisë dhe vendimit për transformim të tokës dhënë nga Ministria për transport dhe lidhje me numër me datë 06.02.3004, prona e lëndë është regjistruar me 1/5 në emër të trashëgimtarëve ligjor nga dhe të tjerë. Në vitin 2016 me listë për ndryshime në bazë të lëndës nga Njësia për kadastër të patundshmërive, është regjistruar sipërfaqe e pronës prej 591m² dhe deri në ditën e sotshme kjo pronë është evidentuar në IL me sipërfaqe prej 591m² me nga 1/5 në emër të trashëgimtarëve ligjor.

Prona e cila është evidentuar në PK me sipërfaqe prej 823m² si tokë punuese dhe 25m² TPO, është regjistruar në Fletë-regjistrim 1763 për të cilën nuk janë regjistruar të drejtat dhe është me shifër 99, lënda nuk është shfaqur. Në vitin 2012, kjo pronë me listën për ndryshime dhe në bazë të elaboratit gjeodezik dhe vërtetimit nga kadastra është regjistruar në IL në emër të RM kurse emri i shfrytëzuesit nga dhe në të njëjtin vit në bazë të vendimit për trashëgimi është regjistruar në IL me 1/4 në emër të trashëgimtarëve ligjor nga dhe të tjerë. Në nëntor të vitit 2012 në bazë të Vërtetimit nr./2012 me datë 28.11.2012 në Agjensionin për kadastër të patundshmërive – Njësia, prona është shënuar në flet-regjistrim me të drejta të pashënuara dhe shifër 99 lënda nuk është shfaqur. Në vitin 2014, janë bërë ndryshime në evidencën kadastrale dhe prona është shënuar në RM shfrytëzues TV dhe nga, kurse SHPK nga Shkupi dhe nga, dhe gjer më sot ka qenë gjendja e njëjtë në këtë PK

- Me datë 01.09.2020, me kërkesë të KSHPK, është dorëzuar përgjigje shtesë nga Agjensionin për kadastrë të patundshmërive – Njësia për kadastrë të patundshmërive, me të cilën dorëzohen kopjet e kërkuara për shënimet e lëndës për ndryshimet e bëra – lista e ndryshimeve.

Gjatë rishikimit të dokumentacionit të plotë me të cilën disponon për këtë lëndë, KSHPK caktoi se:

- Në bazë kërkesa e parashtruesit të denoncimit që të rishikohet urgjentisht Vendimi nr. 16-1-193/2 për transformim të së drejtës së tokës ndërtimore në të drejtë të pronësisë në bazë të pronësisë paraprake dhënë nga Ministria për transport dhe lidhje e cila ka qenë e plotëfuqishme kurse në lidhje me akuzat e tyre të denoncimin e parashtruar se Kadastra e Komunës nuk e ka marrë parasysh këtë Vendim dhe në evidencën kadastrale nuk ka bërë evidentim të transformimit të pronës në emër të parashtruesit të denoncimit, përshkak se Vendimi i theksuar në pjesën listës së ndryshimeve për vitin 2011 për PK nga Vërtetimi për rishikim të historiatit e cila është dorëzuar nga Njësia për kadastër të patundshmërive, në realitet është vendimi i lëndës theksuar në denoncimin e dorëzuar, që don të thotë se e njëjta është bartur në librin

- publik për regjistrim të të drejtave të patundshmërive nga ana e Kadastrës në është regjistruar e drejta e pronësisë të personit të përmendur ose në emër të trashëgimtarëve ligjor;
- Në bazë të akuzave në denoncim për veprim joligjor të Kadastrës në lidhje me atë se prona i është dhënë në qeverisje të personit të tretë të cilit i është dhënë fletë-pronësi pa të drejtë ligjore, në bazë të këtij Vërtetimi lëshuar nga Kadastra me të cilën është evidentuar ndryshimi në evidencën kadastrale në viti 2012, nuk janë vërtetuar akuzat e parashtruesit, për arsye se Vërtetimi nr/2012 me datë 28.11.2012 është evidentuar në kadastrë në vitin 2012, që mund të shihet edhe nga lista e ndryshimeve të numëruara në vitin 2012 në Vërtetimin e dorëzuar për rishikim të historiatit për PK nr. për të cilën është shënuar mosmarrvesha administrative dhe është marrë verdikt nga Gjykata administrative, me të cilën ky Vërtetim i Kadastrës është asgjësuar, Gjykata ka gjetur se janë lënduar rregullat e procedurës me atë që me vërtetimin në realitet është bërë ndryshim, gjegjësisht është bërë fshirje e të drejtave të shënuara në kadastrë të patundshmërive por nuk është bërë menjanim i gabimit teknik, për këtë arsye Gjykata sheh për nevojë që përsëri të rishikon dhe rivendisje për lëndën me çka i sugjeron Kadastrës që gjatë veprimit të përsëritur t'i merr parasyshtë të kuptuarit juridik dhe vërejtjet e dhëna nga kjo gjykatë. Në sqarimin e procedurës së lëndës, e cila është dorëzuar si shtesë të denoncimit të dorëzuar deri te KSHPK, është theksaur se nga ana e organit të paditur është marrë vërtetimi diskutabil për ndryshime të kryera pas identifikimit të kryer plotësues të parcelës kadastrale, dhe me të cilën është caktuar se kjo parcelë kadastrale ka qenë pjesë e parcelës së vjetër PK evidentuar RM – si shfrytëzues TV , që don të thotë se me listën për ndryshime është bërë ndërhyrje dhe nga shoqëria private gjeodezike dhe nga Kadastra, si dhe për lëshimin gjatë përpunimit të të dhënave nga numrat e vjetër në numra të ri në PK, për shkak se sipas Kadastrës ka qenë e nevojshme që të merret Vërtetimi që të bëhet fshirje e ndryshimit. Në Vërtetimin e dorëzuar deri në Njësinë e kadastrës së patundshmërive, mund të shihet se në evidencën kadastrale me listën e ndryshimeve për vitin 2014 është bërë ndryshim të pronës në PK për të cilën mund të parashikohet se është e bërë me veprimin e përsëritur dhe vendimin nga Kadastra për lëndën për këtë parcelë kadastrale, kurse në lidhje me verdiktin e marrë me datë 12.02.2012 dhe vërejtjet e dhëna nga Gjykata administrative për të njëjtën. Gjithashtu, për këtë parcelë kadastrale sipas listës së ndryshimeve në vitin 2015 është bërë edhe një ndryshim në evidencën kadastrale ekzistuese me vendim të Gjykatës themelore Shkup dhe dokumentacionit tjetër në të cilën prona është regjistruar në emër të RM kurse si shfrytëzues SHPK nga Shkupi dhe nga, e cila edhe gjer më sot gjendet në këtë gjendje me këtë PK, që don të thotë për pronën e lëndës është zhvilluar edhe mosmarrveshje gjyqsore, dhe në bazë të verdiketeve për të njëjtin janë bërë këto ndryshime në evidencën kadastrale.

Në bazë të gjendjes faktike të këtyllë, KSHPK konstaton se në lidhje me akuzat për rastin konkret të theksuara në denoncim është vepruar nga ana e organit kompetent kurse ndryshimet në evidencën kadastrale janë bërë në bazë të vendimeve të marra nga mosmarrveshja administrative dhe me verdikte të marra në këtë mosmarrveshje gjyqsore,

me ka vlerёson se Komisioni shtetёror nuk ka elemente pёr veprim tё mёtutjesh pёr kёtё lёndё dhe procedura pёr tё njёjtёn tё ndёrpritet.

Duke marrё parasyshtё tё gjithё tё shёnuarёn mё sipёr, Komisioni shtetёror pёr parandalim tё korrupsionit vendosi si nё dispozitat e kёtij vendimi.

Ёshtё vendosur me datё 29 dhjetor tё vitit 2020, me numёr 12-2242/5

Dorёzuar deri tek: Arkiva dhe parashtruesi

Pas pёrfundimit tё KSHPK

Punoi: J. C., Kёshilltarё

Miratoi: m-r V. G., Anёtari KSHPK

KOMISIONI SHTETЌORЁ PЉR
PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Zёvendёs-kryetarё: Sofka Pejovska Dojcinovska

